



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 2371 prot.

Himarë, më 11 . 11 . 2025

Lënda: Dërgim projektvendimi

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ✓

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, Ligjin Nr.44/2015 “Kodi Civil i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile”, VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimit të komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”;

Po ju dërgojmë projektvendimin, “Për miratimin e planit të masave për emergjencat civile në bashkinë Himarë për periudhën vjeshtë-dimër 2025-2026” si dhe relacionin sqarues.


KRYETARI

Vangjel Tavo

ME DELEGIM DHE ME URDHER

ZEVENDESKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 8371 / prot.

Himarë, më 11.11. 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 58, datë 11.11. 2025

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE
PËR EMERGJENCAT CIVILE NË BASHKINË HIMARË PËR PERIUdhËN
VJESHTË-DIMËR 2025-2026”**

Mbeshtetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, Ligjin Nr.44/2015 “Kodi Civil i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile”, VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimit të komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”

Këshilli Bashkiak Himarën pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Himarë;

VENDOSI

1. Të miratojë planin e masave për emergjencat civile në bashkinë Himarë për periudhën vjeshtë-dimër 2025-2026”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për këtë çështje.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55, pika 6.

KRYETARI
Vangjel Tavo

**ME DELEGIM DHE ME URDHËR
ZEVENDESKRYETARI**
Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E MBROJTJES SË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 8371/12 prot.

Himarë, më 10.11.2025

Lënda: Relacion për miratimin planit të masave për emergjencat civile në bashkinë Himarë për periudhën vjeshtë-dimër 2025-2026,

KËSHILLIT TË BASHKISË HIMARË

I nderuar Kryetar i Këshillit, të nderuar këshilltarë;

Ky relacion ka për qëllim të paraqesë masat e marra dhe planifikimin e veprimtarive për përballimin e situatave të mundshme të emergjencave gjatë sezonit vjeshtë-dimër në territorin e Bashkisë Himarë. Periudha në fjalë karakterizohet nga reshje të dendura, erëra të forta, rrëshqitje dheu, përmbytje të përkohshme dhe vështirësi në qarkullimin rrugor, ndaj është e nevojshme koordinimi i hershëm ndërinstitucional dhe përgatitja e strukturave vendore.

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, Ligjin Nr.44/2015 “Kodi Civil i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile”, VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimit të komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”, Bashkia Himarë duke kryer vlerësimin e risqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore, ju informojmë si më poshtë:

1. MASAT E MARRA DERI TANI

- Është ngritur grupi i punës pranë Bashkisë Himarë për monitorimin e situatave me risk gjatë sezonit vjeshtë-dimër.
- Është kryer Riorganizimi i Komisionit të Mbrojtjes Civile.
- Është kryer inspektimi i rrjeteve kulluese dhe kanaleve të ujërave të larta në zonat problematike (Njësitë Administrative Himarë, Lukovë dhe Horë-Vranisht).
- Është bërë identifikimi i segmenteve rrugore me rrezik bllokimi.
- Është kërkuar nga bashkia dhe Ministria e Mbrojtjes krijimi i rezervave të materialeve emergjente.

2. MASAT PARANDALUESE DHE OPERACIONALE

- Mbajtja në gatishmëri e grupeve të emergjencave në nivel bashkie dhe njësisht administrative.
- Sigurimi i mjeteve për pastrimin e rrugëve dhe lirimin e akseve nga inertet apo shembjet.
- Kontrolli i vazhdueshëm i argjinaturave dhe urave në zonat me risk përmbytjeje.

- Krijimi i një regjistri me banesa të izoluara ose me akses të vështirë për ndërhyrje emergjente.
- Informimi i popullatës përmes kanaleve të komunikimit të bashkisë në rast paralajmërimesh nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.
- Përfshirjen e më shumë se një strukture.
- Zgjerimin e rrjetit me kontakte të reja nga strukturat përgjegjëse për mbrojtjen civile që veprojnë në qark, qofshin këto shtetërore apo private.
- Takim me kryesitë e fshatrave për krijimin e grupeve vullentare.
- Takim për mbashkërendimin e punëve me Drejtorinë e Ndërmarrjes së Shërbimeve.
- Takim me firmat e pastrimit.
- Takim me firmat e mirëmbajtjes së rrugëve nacionale.
- Takim bashkëpunimi me Drejtorinë e Bujqësisë, Pyjeve, Kullotave dhe Ujitjes.
- Takim dhe bashkëpunim me Shërbimin e Emergjencës Shëndetësore.
- Takim dhe bashkëpunim me Policinë Rrugore dhe Policisë së Shtetit.
- Takim dhe bashkëpunim të ngushtë me Stacionin e MZSH.
- Takim dhe bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë.
- Takim dhe bashkëpunim me Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.
- Takim dhe bashkëpunim me OSHE dhe OST.

3. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME


Spektori i emergjencave civile i Bashkisë Himarë është në gatishmëri për menaxhimin e situatave që mund të paraqiten gjatë sezonit vjeshtë-dimër.
Rekomandohet:

- Vazhdimi i bashkëpunimit me Prefekturën Vlorë dhe strukturat e tjera të mbrojtjes civile.
- Aktivizimi i bizneseve lokale me mjete të rënda për ndërhyrje në raste emergjente.
- Përmirësimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm për komunitetin

KRYETARI
Vangjel Tavo

ME DELEGIM DHE ME URDHER
ZEVENDESKRYETARI

Erifili Berberi



Konceptoi: I. Gjika (Përgjegjës)
Miratoi: A. Goro (Drejtör)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E MBROJTJES SË TERRITORIT DHE EMERJENCAVE CIVILE
SEKTORI I EMERJENCAVE CIVILE

Nr. 10/prot.

Himarë, më 10.10.2025

PUNOI
PËRÇJECJËS
Mia Gjika

KONFIRMOI
DREJTOR
Andrea Goro

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
Vangjel Gava

PLAN MASASH

PËR EMERJENCAT CIVILE NË BASHKINË HIMARË PËR PERIUDHËN VJESHTE DUMËR 2025-2026

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore, ligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM nr. 747, datë 20.11.2019 "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile", VKM nr. 923, datë 25.11.2020 "Për funksionimin e organizimit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile" si dhe në përputhje të shkresës nga Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile nr. 1750/1 prot, datë 29.09.2025, protokolluar pranë nesh me nr. 7430 prot., datë 01.10.2025 "Mbi marrjen e masave parandaluese dhe përgatitjen për përballimin e emergjencave civile gjatë periudhës së dimrit 2025-2026", sektori i emergjencave civile pranë drejtorisë së mbrojtjes së territorit dhe emergjencave civile, Bashkia Himarë, hartoi planin e masave si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i objektit që do të realizohet	Përshkrimi i masave	Afatet e përmbyshjes së masave	Përcaktimi i treguesve konkrete për vlerësimin e çdo mase me zbatimin e objektit	Spektori i ngarkuar për realizimin
1.	Menaxhimi i situatës	Riorganizimi i Komisionit të Mbrojtjes Civile dhe koordinimi ndërmjet strukturave.	Deri 25.11.2025	- Kryen riorganizimin e Komisionit të Mbrojtjes Civile - Bën vlerësimin e situatës. - Meri masa të nevojshme për parandalimin dhe ndërhyrjen në rastet e emergjencave civile dhe	Kryetari i Sektorit të Emergjencave Civile

				koordinimin ndërmjet strukturave. - Mblidhen në mënyrë periodike për vlerësimin e masave të marra.	Kryetari
a)	Caktimi i drejtësisë të operacioneve të emergjencave civile.	Në vazhdim		- Në rast të operacioneve të ndryshme të strukturave të emergjencave civile, kur operacioni kërkon përfshirjen e më shumë se një strukture të mbrojtjes civile, apo dhe të strukturave të tjera që veprojnë në territorin e bashkisë, kryetari i bashkisë të caktojë drejtësinë e operacionit në nivel bashkie.	
b)	Përditësimi i planeve të emergjencave civile me ndryshimet e ndodhura (nëse ka të tilla).	Në vazhdim		- Bën përditësimin e planeve të emergjencave civile. - Bën ndryshimet e ndodhura si në aspektin e ndryshimit të strukturës që veprojnë në nivel bashkie, ashtu edhe në aspektin e risqeve të shtuara.	Sektor i Emergjencave Civile
2.	Kontakte	Deri 25.11.2025		- Bën përditësimin e kontakteve elektronike dhe adresave në rrjetin e komunikimit, si dhe zgjerimin e këtij rrjeti me kontakte të reja nga strukturat përgjegjëse për mbrojtjen civile që veprojnë në qark, qofshin këto shtetërore apo private, duke bërë lajmërimin e hershëm funksional.	Sektor i Emergjencave Civile
3.	Takime sensibilizimi	Takim me Kryesinë e Fshatrave. Deri 25.11.2025		- Takim me Kryesinë e fshatrave për krijimin e grupeve vullentare në rast emergjencash për çdo fshat.	Komisioni i Emergjencave Civile
4.	Takime bashkëpunimi	Takim me Drejtorinë e Ndërmarrjes së Shërbimeve Deri 25.11.2025		- Takim për mbashkërendimin e punëve me Drejtorinë e Ndërmarrjes së Shërbimeve për masat e marra për pashtrimin e përrerjve, tobinove, urave, nënkalinëve, kanaleve kulluese, ujërë dhe masa të tjera që kanë ndikim në emergjencat civile. - Në segmentet rrugore kombëtare dhe rurale, të cilat që gjatë viteve të kaluara janë bllokuar nga dëbora, bashkitë dhe subjektet e kontraktuara për	Drejtoria e Ndërmarrjes së Shërbimeve Sektor i Emergjencave Civile

			mirëmbajtjen e tyre, të depozitojnë materiale ndihmëse (skorie), kripë dhe të dislokohen mjete borëpastnuese dhe kripëhedhëse. - Në zonat që mund të bllokohen nga dëbora, të krijohen rezerva dimërore me ushqime për banorët, bazë ushqimore për bagëtitë, duke realizuar marrëveshje me subjekte private. - Të merren masa për sigurimin e ngrohjes në shkolla.	
a)	Takim me firmat e pastirimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve nacionale dhe koordinim në rast emergjencash.	Deri 25.11.2025	- Takim me firmat e pastirimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve nacionale. - Koordinim në rast emergjencash - Të mbahen në monitorim të vazhdueshëm veprat e artit (urat, nënkalinet). - Në segmentet rrugore kombëtare dhe rurale, të cilat që gjatë viteve të kaluara janë bllokuar nga dëbora, bashkitë dhe subjektet e kontraktuara për mirëmbajtjen e tyre, të depozitojnë materiale ndihmëse (skorie), kripë dhe të dislokohen mjete borëpastnuese dhe kripëhedhëse.	Firmat e pastirimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve nacionale. Sektor i Emergjencave Civile
b)	Takim bashkëpunimi me Drejtorinë e Bujqësisë, Pyjeve, Kullotave dhe Ujitjes	Deri 25.11.2025	- Në zonat që mund të bllokohen nga dëbora, të krijohen rezerva dimërore me ushqime për bagëtitë, duke realizuar marrëveshje me subjekte private. - Të mbahet në monitorim të vazhdueshëm gjendja teknike e rezervuarëve (digave, ujëleshuesve dhe ujëleshuesve katastrofikë), si dhe kontrolli i nivelit të ujit në rezervuarë, duke bërë kontrole të vazhdueshme sipas udhëzimit të përgjithshëm të KKDM mbi dosjen teknike/pasaportën e digave. - Të mbahen në monitorim të vazhdueshëm kanalet kulluese dhe ujitëse, kanalet e ujërave të larta, përrënjtë.	Sektor i Emergjencave Civile Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Kullotave dhe Ujitjes

c)	Takim dhe bashkëpunim me Shërbimin e Emergjencës Shëndetësore, Policisë Rrugore, dhe Stacionit të MZSH	Deri 25.11.2025	- Të bashkëpunojnë ndërmjet tyre në të gjitha rastet e emergjencave që mund të shkaktohen nga aksidentet rrugore. - Të jenë në gadishmëri të plotë mjeteve zjarfikëse dhe infrastruktura e shpëtimit për ç'do rast emergjence. - Të jenë në gadishmëri të plotë mjeteve (Ambulanca) e Shërbimit të Emergjencës Shëndetësore.	Sektori i Emergjencave Civile Shërbimi i Emergjencës Shëndetësore, Policia Rrugore, dhe Stacioni i MZSH
d)	Takim dhe bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë dhe Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor	Deri 25.11.2025	- Të evidentojnë familjet vunerabel, çiftet/gytetarët në moshë të madhe që banojnë vetëm. - Të evidentojnë të sëmurët me dializë dhe gratë shtatzëna me banim në zonat që mund të bllokohen nga dëbora dhe të kenë një plan evakuimi të tyre në rast bllokimi. - Të merren masa për furnizimin me medikamente të qëndrave shëndetësore në zonat që mund të bllokohen nga dëbora.	Sektori i Emergjencave Civile Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
e)	Takim dhe bashkëpunim me OSHE dhe OST	Në vazhdim	- Të merren masa për sigurimin e vazhdimësisë së furnizimit të popullsisë me energji elektrike, duke marrë masa për riparimin në kohë të difekteve që mund të ndodhin.	Sektori i Emergjencave Civile OSHE dhe OST
5.	Kontakti i emergjencës	Në vazhdim	- Kontakti me Qëndren Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile është 0694110198	Komisioni i Emergjencave Civile
6.	Analiza	30.04.2026	- Pasi të kemi dalë nga sezoni i dimrit do të bëhet bilanci i punës për të gjitha deyrat e lëna dhe realizimi i tyre.	Komisioni i Emergjencave Civile i Bashkisë Himarë